

TOMORR PLANGARICA**PËRKTHIMET DHE PARAPËLQIMET LETRARE E KULTURORE,
SI TREGUES I POZICIONIMIT ESTETIK-LETRAR
DHE PARATOPIË KRIJUESE TË POETIT VILSON BLOSHMI****Abstrakt**

Studimi synon të sjellë të dhëna dhe të bëjë interpretime për një rast tejet specifik në letrat shqipe, për një poet, krijimtaria e të cilit u vu në kontakt me lexuesin veçse shumë vite pas largimit nga jeta të autorit të tyre. Bëhet fjalë për Vilson Blloshmin (i pushkatuar kur ishte 29 vjeç (1948-1977)), i cili shkroi poezi, përktheu krijime letrare, kryesisht nga letërsia franceze, por nuk mundi të bëjë publike qoftë krijimet e tij poetike origjinale, qoftë përkthimet letrare, sepse nuk arriti të bëhet pjesë e fushës letrare të kohës, si pasojë e paragjyqimeve klasore.

Qasjet a pikëvështrimet e sotme në studimet letrare, në shkencat e ligjërimit e përkatësisht në analizën e diskursit letrar, konceptet dhe interpretimet për nocionet a kategoritë *vetje biografike* (individ me biografinë përkatëse jetësore jashtëletrare), *shkrimtar*, *thënës a thëniepërfutës në tekst* (enonciateur), *dokument/dorëshkrim*, *tekst* (letrar) a *vepër* (letrare) ndihmojnë në shqyrtimin dhe rikuptimësimin e kësaj trashëgimie në dorëshkrim të V. Blloshmit që, në kontakt tashmë me lexuesin e sotëm, është formësuar si *vepër* letrare. Përkthimet, si dhe tekstet në frëngjisht të autorëve francezë, kryesisht të shekujve XIX dhe XX, të kopjuara me shkrim dore nga botime të ndryshme në gjuhën frënge, krijojnë një “antologji” poetike, e cila, edhe pse nuk erdhi e tëra në shqip, ndihmon të njihen parapëlqimet e tij letrare e kulturore, pozicionimi i tij estetik; ndihmon të njihet më nga afër procesi krijues i poetit, *paratopia krijuese* e tij; e, në këtë mënyrë, ndihmohemi të rikuptimësojmë dhe shijojmë edhe krijimtarinë origjinale poetike të tij.

Fjalë kyçe: *autor, vetje biografike, shkrimtar, qenie tekstore, paratopi, pozicionim estetik, skenë e të thënit, dorëshkrim, dokument, vepër letrare*

Kahe të caktuara studimore dhe disiplina të ndryshme në hapësirën studimore të shkencave të ligjërimit po sjellin prurje me vlerë në shqyrtimin e tekstit/diskursit letrar dhe dukurive letrare. Përmes prurjeve të tyre shkencore janë përpunuar koncepte e metodologji që mundësojnë ndriçimin më të plotë të profileve të caktuara të objektit të studimit të letërsisë, madje ato kanë mundësuar edhe një rikonceptim të funksioneve të produktit letrar si aktivitet

social. Kahe studimore e disiplina të tilla si pragmatika gjuhësore e letrare, analiza e diskursit a analiza tekstore e diskursit, teoritë e të thënit/enoncacionit, semantika e tekstit e diskursit, me këndvështrimet e tyre të reja dhe konceptet e përpunuara, kanë nxitur thellime e rikonceptime në disiplinat e studimeve letrare, si sociokritika, etnologjia e sociologjia e letërsisë, antropologjia letrare etj. Koncepte të tilla, si *diskurs*, *diskurs zanafillor/konstituant*, *paratopi*, *skenë e të thënit/enoncacionit* apo entite të tilla si *vepër*, *tekst*, *dokument*, *autor* (me përbërësit e tij *vetje biografike*, *shkrimtar*, *thëniepërfutës/thëniebartës* a *qenie tekstore*) etj. po fitojnë gjithnjë e më shumë vend në studimet letrare europiane e më gjerë, përvojë e cila meriton të zërë vendin e duhur edhe në studimet tona letrare.

Metodologjitë e përvijuara në këto hapësira studimore dhe konceptet e përpunuara në to ndihmojnë për të ndriçuar aspekte a profile të caktuara të krijimtarisë dhe vlerës sociale edhe të poetëve që përfshihen në fushën letrare a institucionin letrar në mënyrë tejet të veçantë, siç është rasti i Vilson Blloshmit, krijimtaria poetike origjinale dhe përkthimtarja e të cilit u formësuan si *vepër*, në kontakt me lexuesin, veçse shumë vite pas largimit të tij nga jeta.¹

Në vijim nuk synojmë të shqyrtojmë veçanërisht krijimtarinë e tij poetike, por të vëmë në dukje rëndësinë që ka për lexuesin e sotëm njohja e sfondit vetjak kulturor, intelektual e letrar në të cilin u përftua pozicionimi estetik i V. Blloshmit, marrëdhëniet dhe veçantia e përkatësisë së tij në institucionin letrar, paratopia e tij krijuese (sipas termave të D. Maingueneau-së), që i mundësoi modernitetin shprehës atyre krijimeve poetike, të cilat receptohen të tilla edhe pse lexuesi i tanishëm është përtej kohës në të cilën u shkruan poezitë e tij.

¹ Vilson Blloshmi (18.03.1948-17.07.1977) lindi në Bërzesh të Librazhdit. Pas përfundimit të shkollës së mesme pedagogjike në Elbasan, për arsye politike (familja e tij ishte shpallur „kulak“) nuk iu dha e drejta e vijimit të studimeve në arsimin e lartë. Madje nuk iu dha as e drejta e ushtrimit të profesionit të mësuesit, ndaj qe i detyruar të punojë në fshatin e tij si bujk, si druvar në Stravaj e si minator në minierën e Përrenjasit. Me dhuntinë e lindur të poetit dhe vullnetin e paepur të njeriut të etur për dije e kulturë, i kundërqëndroi heshturazi privimeve sociale dhe qe i vetëdijshëm që nuk do të gjente hapësirat që meritonte në institucionin a fushën letrare të kohës; shkroi poezi (edhe pse nuk arriti të botojë asnjë prej tyre), mësoi gjuhë të huaja, u dashurua veçanërisht pas gjuhës frënge, kulturës e poezisë franceze, sidomos asaj të shekullit XIX dhe XX, projektoi të sillte në shqip perla të asaj krijimtarie, prej së cilës arriti të përkthejë veçse një pjesë të tyre (nuk arriti po ashtu të bëjë publike asnjë prej përkthimeve). U arrestua në gusht të vitit 1976 dhe, nën akuzën për “sabotim në ekonomi dhe agjitacion e propagandë”, u pushkatua më 17 korrik 1977 (së bashku me kushëririn e tij, po ashtu poet, Genc Leka). Trashëgojmë prej tij veçse dorëshkrime të kësaj pune krijuese e intelektuale (edhe ato, pjesa më e madhe të gjendura dosjeve të hetuesisë, pas konfiskimit), dorëshkrime që u botuan shumë më vonë dhe tani janë në komunikim me lexuesin.

Lënda letrare që ai na ka lënë në formën e dorëshkrimeve (të poezive origjinale, por edhe të përkthimeve të shumë prej perlave të poezisë franceze), e shndërruar prej nesh në *objekt studimi*, mundëson qartësimin më të plotë të vetë dukurisë së veçantë letrare që ngjiz figura e këtij poeti në letrat shqipe (me një jetë fizike në skajet periferike të shoqërisë shqiptare të kohës, larg dhe i papranuar në mjedisin intelektual e fushën letrare të kohës, me një jetë të shkurtër e të ndërprerë dhunshëm).

•*Diskursi poetik dhe poeti-përkthyes*

Është një përvojë që haset jo rrallë në fushën e përkthimitarisë, që teksti poetik të përkthehet, përshtatet, riformësohet a transpozohet në gjuhën pritëse nga përkthyes që janë njëherazi edhe poetë.²

Edhe pse për përkthimin e krijimeve poetike të qenët poet nuk është kusht për t'i përkthyer ato, ka një mori arsyesh që lidhen me vetë natyrën e diskursit poetik, që ka nxjerrë në pah si të suksesshme pikërisht edhe angazhimet e *poetëve-përkthyes* në këtë proces. Janë arsye që lidhen me vetë tekstin poetik që ngjizet si një formë tejet e veçantë simbolike e karakterizimit të botës dhe shprehjes së ndjesive (që si e tillë do të kërkojë përgjegjësen edhe në gjuhën pritëse), por njëherazi edhe si një akt ligjërimitor i ngjizur përmes përzgjedhjeve të kujdesshme gjuhësore (të natyrës fonetike e prozodike, leksikore e semantike, sintaksore e pragmatike) që, si të tilla, do të duhet të vijnë edhe në gjuhën në të cilën përkthehet.

Me këtë larmi treguesish të ngjizjes së diskursit poetik, poeti është në përballje të përditshme, ndërsa përvijon rrugëtimin e tij letrar në gjuhën e tij dhe, në këtë mënyrë, edhe më i familjarizuar me to për t'i transpozuar në gjuhën pritëse, ndërsa ndërmerr aktin e përkthimit.

Përgjatë shekujve, kjo procedurë ka krijuar përvojë të suksesshme në këmbimin e vlerave kulturore letrare e poetike; edhe në hapësirën kulturore

² Themi “transpozohet”, duke parakuptuar jo vetëm formësimin e brendisë në gjuhën pritëse, por edhe simbolikën e përfutur rishtas; kemi pasur parasysh pikëvështrimin e R. Jakobsonit kur pohon se “poezia si përkufizim është e papërkthyeshme. Është i mundshëm veçse transpozimi krijues” (*Aspects linguistiques: de la traduction* në “Essais de linguistique générale”, Paris, Ed. de Minuit, 1986, f. 86). Siç vërehet tashmë në studime të ndryshme, “në këtë përcaktim shihet ndikimi i tezave të W. von Humboldt sipas të cilave poezia do të ishte një mënyrë të foluri që ndërmerr lidhje “mistike” me gjuhën, një simbol i një vizioni të veçantë të botës (një *Weltanschauung*). Ky raport kalon nëpërmjet shenjave dhe tingujve të kombinuar në mënyrë të pandashme, sepse poezia është një mënyrë të shkruari që ka të bëjë me temperamentin dhe anën simbolike *par excellence* “ (cituar nga Christine Lombez, *Traduire en poète, Philippe Jaccottet, Armand Robin, Samuel Beckett, Le Seuil, “Poétique”, 2003, n°135, f. 355. [edhe En ligne]*

shqiptare përkthimet e poetëve-përkthyes, po ashtu, kanë krijuar përvojë të suksesshme.

Pririmi ta kontekstualizojmë në këtë hapësirë përpjekjen dhe përvojën përkthimore të V. Blloshmit për të sjellë në shqip, transpozuar a shqipëruar disa krijime poetike në zë të autorëve francezë të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX. Në fakt, kemi prej tij një tubë poezish të shqipëruara, në përbërje të një “antologjie” letrare shumë më të gjerë të formësuar prej tij me tektet në frëngjisht, me krijime të poetëve më në zë francezë të asaj periudhe, të përçokura me kujdes, të kopjuara me shkrim dore, prej të cilave jo pak ishin menduar të përktheheshin më vonë prej poetit (por, për të cilin, ajo “më vonë” nuk erdhi).

Janë krijimet e tij poetike, të lëna gjithashtu si dorëshkrime dhe një tubë poezish nga ajo antologji, të shqipëruara në atë ndërkohë, në gjallje të tij, që mundësoi që, “më vonë”, ato të fitonin statusin e *veprës* së tij *letrare*.³

Është gjithsesi një proces jo i zakonitë ky i V. Blloshmit që mundëson shndërrimin e atyre dorëshkrimeve në vepër letrare. Për ta përshkruar këtë proces, është e nevojshme të ndriçohet nga fare afër e gjitha ajo trashëgimi dorëshkrimesh, sepse në tërësinë e saj bartet *tharmi* që do ta shndërrojë më vonë në vepër; gjithashtu, përmes tërësisë së atyre dorëshkrimeve kemi mundësinë të kuptojmë që në to është projektuar *përmasa shtesë* që do të fitojë emri i V. Blloshmit (si emërtim i personit fizik), në atë të *autorit* të *veprës* letrare.

³ Duke pasur parasysh këndvështrimin e F. Rastiesë (F. Rastier) në dallimin mes nocioneve e kategorive *dokument*, *tekst* dhe *vepër* (në “La sémiotique des textes, du document à l’oeuvre” në “Documents, textes, œuvres”, Rennes, PUR, 2014: 13-39), po theksojmë përmbledhtas se, në vijim, me *dokument* do të parakuptojmë *dorëshkrimin* e paintegruar në procesin e komunikimit, dëshmi të një përpjekjeje vetjake të të shkruarit mbi një objekt shkrimi; me *tekst*, mesazhin shkrimor që interpretohet përgjatë leximit, në përbërje të një korpusi edhe më të gjerë mesazhesh, në marrëdhënie ndërtekstore me mesazhin përkatës, që bart vlera sa etike po aq edhe estetike; dhe me *vepër*, një tekst a tërësi tekstesh si vlerë kulturore, në kontakt me lexuesin dhe të mundësuar nga ndërmjetës të natyrave të ndryshme që realizojnë këtë kontakt.

Nga ky pikëvështrim, *dorëshkrimet* që V. Blloshmi ka lënë në formën e poezive, përkthimeve, shënimeve, ditarit, etj. “u lexuan” si *tekste* përgjatë procesit të hetuesisë që e dënoi me vdekje, u (keq)kuptimësuan dhe (keq)interpretuan në ato kontakte të para me lexuesin, nga ai lloj lexuesi, që krijesën poetike të Blloshmit nuk e priti me duart e kujdesshme e të brishta të mamisë, por me duart që mbanin veglat e xhelatit. Dhe shumë vite pas pushkatimit të poetit, ato dorëshkrime e tekste futen në kontakt me lexuesin e gjerë, përmes procesit botues, kritikës e studimit të instancave shqyrtuese të institucionit letrar të ditëve tona, studiuësve, kritikëve letrarë, mësuesve të letërsisë etj., duke përfaqësuar në këtë mënyrë *veprën letrare* të V. Blloshmit.

Ndriçimi s'mund të jetë i plotë, gjithsesi, nëse do të përqendrohemi vetëm te dorëshkrimet e krijimtarisë letrare origjinale, pa marrë në shqyrtim edhe përkthimet, shënimet a ditarët, madje domosdoshmërisht edhe kuturisjen e tij për të pasur të tijën “antologjinë” me krijime nga poetët francezë të shekullit XIX, XX e “grimca” të tjera nga trashëgimia letrare, filozofike e kulturore europiane në shekuj.

Nëse s'mund të flasim për veprën e mëtejshme që V. Blloshmi mund të na sillte (si krijimtari origjinale apo si përkthime), na mbetet detyrim intelektual ta ndriçojmë projektimin e saj prej staturës së shkrimtarit që ai po mundohej të trupëzonte, të cilën po ashtu e humbëm; e në këtë mënyrë, dhimbja për ndërprerjen e asaj krijimtarie, i shtohet dhimbjes së madhe të dënimit me vdekje padrejtësisht të njeriut; dhe nuk është më vetëm dhimbje e familjes, e të afërmëve apo e miqve, por ka përmasat e dhimbjes sociale.

• *Prej emrit që përfaqëson individin, te emri i autorit*

Ishte e natyrshme që në fillim të viteve 1990, pas ndryshimeve politike dhe ideologjike që ndodhën në shoqërinë shqiptare, emrat e poetëve Vilson Blloshmi e Genc Leka të ishin të pranishëm në diskursin e kohës, sepse ata përfaqësonin sjelljen e skajshme kriminale të regjimit të kaluar ndaj individit, ku viktimit mund të ishte edhe poeti, edhe artisti. Gjithsesi, përmendja e tyre zinte vend më shumë në diskursin politik e ideologjik të kohës, sesa në atë letrar e kulturor. Dhe ishte i natyrshëm ky vend në diskursin e kohës, sepse trashëgimia e tyre letrare ndodhej ende në formën e dorëshkrimeve, dokumenteve të mbyllura në dosjet e policisë sekrete, dhe aspak si një *vepër* letrare që i nënshtrohej ecurisë së kontakteve me lexuesit, vlerësimit, rindërtimit e rikuptimësimit të mesazheve përmes akteve të të lexuarit nga një lexues më i kualifikuar, e po ashtu edhe nga lexuesi i zakonshëm.

Me gjetjen, grumbullimin, botimin e vlerësimit të trashëgimisë së tyre shkrimore e poetike, emri i tyre është pjesë e diskursit letrar e estetik, pjesë e interesimit të studiuesve dhe kritikëve letrarë të veprës letrare që ka nisur e vijon tashmë komunikimin me lexuesin.

Ka nisur, tashmë, të përvijohet shndërrimi i trashëgimisë shkrimore të tyre në *vepër letrare*; dhe nga ana tjetër, kalimi i emrit të krijuesve si *qenie biografike* në emrin e krijuesit të veprës letrare, me specifikën e bartur tashmë në emërtim si *Autori/Shkrimtari*. Janë dy forma emërtimi që në studimet letrare (nëse do të shprehemi përmes Mishel Fukosë (Michel Foucault)), nuk janë më izomorfe a të së njëjtës formë, janë të diferencuara. Kur flasim për emrin e autorit dhe më tej figurën a imazhin e autorit, nuk kemi parasysh thjesht personin fizik që mban a thirret me atë emër, por personin të lidhur me një vepër, e nëpërmjet saj, personin që ka arritur të përftojë një pozicionim të caktuar estetik dhe të formësojë në procesin krijues, në procesin e të shprehurit

a të thënit në vepër, një zëdhënës, thëniepërfutues, thëniebartës a nënshkrues të mesazheve të tij.⁴

Ndërsa jemi tashmë në kontakt me veprën letrare (edhe pse ajo është përfutur nga dorëshkrimet e pabotuara - *krijime origjinale* a *përkthime* qofshin ato⁵), edhe kërkimet për krijuesin e saj janë përpjekje për të grumbulluar të dhëna për *autorin* dhe jo thjesht *personin fizik* që na ka lënë trashëgim ato dorëshkrime. Studimet letrare dhe shkencat e ligjërimit sjellin përgjigje për përbërësit e këtij entiteti të veçantë, që sigurisht e parakupton edhe personin biografik, por, më së tepërmi, edhe dy instanca të tjera “brenda” krijuesit, që janë “shkrimtari” dhe “qenia tekstore/nënshkruesi”, ai që merr përsipër të bartë e përçojë mesazhe përmes vetë tekstit në krijimtarinë e tij origjinale, “nënshkruesi” i atyre pohimeve, përjetimeve e simbolikave të bartura në veprën e tij.

Përmes D. Maingueneau-së do të theksonim se në entitetin “krijues-autor” barten tri instanca përbërëse që i japin jetë krijimtarisë: *personi fizik*, *shkrimtari* dhe *qenia tekstore a nënshkruesi* në tekst. Emërtimi “person” i referohet individit të pajisur me të dhënat e një gjendjeje civile, të një jete vetjake, private; “shkrimtari” tregon aktorin që përvijon një trajektore në institucionin letrar; ndërsa “nënshkruesi” tregon thënësin në tekst, subjektin e procesit të të thënit që bart e transmeton njëherazi edhe statusin e përvijuar ndërkohë të individit biografik e shkrimtarit në fushën letrare”⁶. Këto tri

⁴ I qasemi në këtë mënyrë figurës së autorit, për të mundësuar interpretime më të sigurt e më të plota në lidhje me veprën dhe procesin e ngjizjes së saj. Sipas M. Fukosë ka një ndryshim mes një emri të përveçëm të zakonshëm dhe një emri autori; sipas tij “lidhja e emrit të përveçëm me individin që mban këtë emër dhe emrit të autorit me personin që e mban, nuk janë izomorfe dhe nuk funksionojnë në të njëjtën mënyrë. [...]emri i përveçëm “Pierre Dupont” i referohet një personi, pavarësisht vetive që ai bart, ndërsa emri i autorit “Shekspir” është ai që ka shkruar veprat që i atribuojmë këtij emri dhe individualiteti i të cilit do të ishte tjetër nëse edhe vepra do të ishte po ashtu tjetër”. Gjithsesi, duke i njohur këtë status të autorit, nuk e kemi vendosur në hierarkinë e vlerave; duhet studiuar e interpretuar nga afër vepra e tij në të gjithë përbërësit. Siç thekson studiuesja Inger Östenstad, “emri i autorit është i rëndësishëm për interpretim më shumë se të përvijojë një vend të caktuar në diskursin letrar dhe të bartë një funksion mirëfilli taksonimik” (cituar nga Inger Östenstad, *Quel importance a le nom de l'auteur?*, Argumentation et Analyse du Discours, Ethos discoursif et image d'auteur”, 3/2009). [En ligne: URL : [http:// journals.openedition.org/aad/665](http://journals.openedition.org/aad/665) ; DOI : 10.4000/aad.665]

⁵ Edhe përvoja kulturore europiane, e më gjerë, ka shembuj jo të paktë që pjesë e identitetit të poetëve në zë të bëhet edhe ajo pjesë e punës së tyre që ka të bëjë me përkthimtarinë, që zë vend, po ashtu, brenda veprës së botuar me krijimtarinë origjinale të tyre.

⁶ Shih Dominique Maingueneau, *Le discours littéraire, Paratopie et scène d'énonciation*, Armand Colin, 2004, 2014, f. 107-108.

instanca s'mund të mendohen të ndara nga njëra-tjetra, apo në një shfaqje lineare të njëpasnjëshme në formësimin e tyre, por të ndërthurura me njëra-tjetrën, që kushtëzojnë praninë e njëra-tjetrës “si një strukturë e *nyjës borromiane*, tri unazat e së cilës ndërthuren me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që, nëse njëra prej tyre shkëputet, edhe lidhja e dy të tjerave zhbëhet. Nëpërmjet nënshkruesit, është gjithashtu personi e shkrimtari që shprehet; nëpërmjet personit, është gjithashtu shkrimtari dhe nënshkruesi që gjallojnë; nëpërmjet shkrimtarit, është gjithashtu personi dhe nënshkruesi që përvijojnë një trajektore në hapësirën letrare. Nëse e zhbëjmë këtë lidhje, i zgjidhim ato, çdo unazë nxjerr në pah edhe atë çka të tjerat bartin: si të gjallohet, nëse nuk do të jetohet në mënyrën që përshtatet për të qenë ky shkrimtar që do të jetë nënshkruesi i kësaj vepre? Si të zhvillohen strategji në hapësirën letrare, nëse nuk arrijmë të jemi nënshkrues i një vepre? Si të jemi nënshkrues i një vepre, nëse nuk shprehemi nëpërmjet një pozicionimi të caktuar në fushën letrare dhe një lloj mënyre të pranisë/mungesës në shoqëri? Pikërisht “paratopia”, negocimi i vijueshëm për një përkatësi të pamundur është forca nxitëse e vënies në funksion e këtyre instancave që përvijojnë procesin krijues”.⁷

Pra, individi biografik, kur ka arritur të krijojë emrin e *Autorit*, i ka shtuar përmasat emrit të përveçëm të tij, duke u bërë pjesë e institucionit letrar, duke vendosur njëherazi lidhje e raporte me fushën letrare dhe “sivëllezërit” e tij me përkatësi në atë institucion, me të cilët ai ka “komunikuar”, pavarësisht nga koha e hapësira. S’është e thënë që ata “sivëllezër” të jenë bashkëkohësit e tij, në vendin e tij, që përfaqësojnë “fushën letrare” në atë kohë dhe atë hapësirë konkrete në të cilën personi biografik gjendet. Sipas D. Maingueneau-së, për t’u bërë pjesë e sivëllezërve të tu krijues, nuk është e detyrueshme në çdo rast të kesh dekretim, miratim a njohje të ndërsjellë për t’u pranuar në atë rreth a grupim. Madje, “ekzistojnë po ashtu jo pak “familje krijuesish të padukshme”, që luajnë rol në skakierën letrare, pa marrë formimin e një grupi të përvijuar. Për më tepër, çdo shkrimtar përfshihet natyrshëm në një familje të përzgjedhur, atë të shkrimtarëve të së shkuarës ose bashkëkohës, të njohur personalisht ose jo, të cilët ai i vendos në panteonin e tij vetjak, mënyra e jetës dhe vepra e të cilëve i mundëson të legjitimojë shprehjen e tij letrare, krijimtarinë e tij. Ky komunitet shpirtëror, i përfutur në hapësirë e kohë vë pranë e pranë emra në një konfigurim të tillë që kushtëzohet veçse nga qasjet e kërkesat estetike të vetë autorit”.⁸

Për fat, V. Blloshmi, përmes përkthimeve të tij dhe “antologjisë” së përfutur, na e ka lënë të qartë dëshminë se në cilat porta ka trokitur, pjesë e cilës “familje” mëtonte të ishte.

⁷ Dominique Maingueneau, po aty, f. 108.

⁸ Dominique Maingueneau, vep. cit. F. 75.

Madje përmes Inger Østenstad-it do të shtonim se “duke krijuar një emër të autorit dhe një lidhje estetike dhe letrare përmes krijimtarisë së tyre me të tjerë, shumë shkrimtarë përvijojnë një rimarrje thujse magjike me emrat e pararendësve të tyre dhe emrat e autorëve të dashur për to janë në këtë mënyrë po aq qoka përcaktuese që na mundësojnë të përcaktojmë një pozicionim të tyre në fushën letrare”.⁹

Është e rëndësishme t’u qasemi të gjitha atyre dorëshkrimeve, produkt i një jete jo të zakonit të shkruarit të tyre, sepse veçse prej tyre mund të shpjegojmë se si individi, i detyruar të jetojë i shpërfillur dhe i braktisur nga mjedisi social të cilit natyrshëm i përket, arrin të kultivojë një tjetër përmasë të vetëqenies, atë të *shkrimtarit*, dhe, përmes saj, të bëhet pjesë e institucionit letrar dhe e shoqërisë në një kuptim shumë më të gjerë sesa përkatësia në shoqërinë e zakonshme (në mos në kohën e tij, qoftë edhe më vonë). Është një ecuri e pazakontë për përditshmërinë e një individi, por tejet domethënëse për atë të shkrimtarit.

I pazakontë është shndërrimi i dorëshkrimeve të V. Blloshmit në vepër letrare, ashtu si dhe përvijimi prej tij i statusit të autorit. E pazakontë është jeta e V. Blloshmit si individ e krijues, e kaluar nën peshën e rëndë të paragjykitimit të nxitur nga lufta e klasave, që i ngushtonte hapësirat e një jete normale; e pazakontë jeta e këtij individi si qenie sociale, të cilit, për ironi të fatit, investimi që bëri për formësimin e profilit krijues, nuk arriti t’ia zgjerojë atë hulli jetësore, por, në të kundërt, “ndihmoi” të ndërpritet ai rrugëtim krijues. E pazakontë, po ashtu, edhe përpjekja e V. Blloshmit për të pasur një formim sa më të gjerë kulturor, kuturisja e tij në fushën e intelektualitetit e të përkthimtarisë, ndërsa mëton e ëndërron të bëhet pjesë e institucionit intelektual e letrar të kohës, edhe pse shpërfillet e i pamundësohet ngultazi përfshirja në to për arsye jashtintelektuale e letrare; dhe po aq i pazakontë edhe ngulmimi i tij dhe gjetja e rrugëve të tjera për t’u bërë pjesë e institucionit letrar (edhe jashtë fushës letrare në vendin e tij), përtej kohës dhe hapësirës së ngushtë që jeta fizike i impononte. Fatmirësisht, ai arriti të endet hapësirave të tjera të intelektualitetit dhe që i aftë t’i kaptojë ato. E pazakonta për përditshmërinë e personit biografik, në këtë rast mbushet me brendi prej së zakonit dhe domosdoshmërisë së qenies *shkrimtar*.

Ndërsa krijimet origjinale të V. Blloshmit na mundësojnë të gjejmë, analizojmë e interpretojmë veçantitë e “qenies tekstore” që është formësuar në to (marrëdhëniet ndërdisursive e ndërtektore që ajo “qenie” vendos me lexuesin në/dhe diskursin letrar poetik), përkthimet nga frëngjishtja, por edhe “antologjia” me tekstet e poetëve e shkrimtarëve në zë, thëniet, sentencat a fjalët diturake të përzgjedhura në thesarin e pafund të trashëgimisë kulturore,

⁹ Shih Inger Østenstad, vep. cit. [En ligne,

URL:<http://journals.openedition.org/aaad/665;OOI:10.4000/aaad.665>]

na mundësojnë të shqyrtojmë trajektoren e përvijuar nga instanca tjetër e entitetit krijues, “shkrimtari”; ato janë dëshmi tejet domethënëse e pozicionimit dhe rolit që merr a mëton të marrë përsipër individit në institucionin a fushën letrare, me anë të së cilës integrohet në familjen a grupimin e dëshiruar dhe të projektuar përmes veprës së tij.

Është kjo përpjekje e vazhdueshme për një hapësirë që mbetet gjithnjë mes kufijsh, që shfaqet në lidhjen *individ-kohë*, ndërsa shkrimtari gjithnjë mëton përtej asaj çka është e zakonshme, e rëndomtë në kohën e tij, që, sipas D. Maingueneau-së, përvijohet nën moton “koha ime, nuk është koha ime si krijues”; në lidhje me hapësirën e tij rrethuese, nën moton “vendi im, nuk është vendi im”, duke mëtuar një përkatësi në rrethana shumë më të mira; në lidhje me ligjërimin, nën moton “gjuha ime, nuk është gjuha ime”, duke mëtuar përsosje të vijueshme në ligjërimin e tij etj. Pra, është një kërkesë e vijueshme e shkrimtarit për të mos u konfunduar me shoqërinë e zakonshme, por, përmes institucionit letrar, të kapë e trajtojë ato aspekte që çojnë në zhvillim a nxisin vlera estetike, kulturore, shpirtërore. “Mjediset letrare janë në fakt mes kufijsh. Ekzistenca sociale e letërsisë parakupton njëherazi pamundësinë për t’u mbyllur në vetvete dhe pamundësinë për t’u konfunduar me shoqërinë e rëndomtë a të zakonshme”¹⁰.

Është ky status në përvijim e sipër që i mundësoi V. Blloshmit të lërë dorëshkrime të vlerta që më vonë i mundësuan të përfaqësonin veprën e tij letrare dhe vetë atij statusin e autorit, dhe jo thjesht të një shkruesi të talentuar sipas kërkesave të vargëzimit.

Ishte rezonimi, bashkëmarrëdhënia e ndërthurja e këtyre tre përbërësve të identitetit të tij krijues që mundësoi të përvijojë staturën e autorit me veprën e tij, që po i mundëson kontaktet me lexuesit e sotëm. Është, më së pari, individit biografik që do t’i shkonte për analogji pamja simbolike e *Janusit* mitik, me dy shfaqjet e përkundërta të pamjes së tij, në shpinë të njëra-tjetrës a në pozicion të përkundërt me njëra-tjetrën; pra, në njërin anë, në njërin shfaqje, V. Blloshmi si genie fizike e sociale, me çapitjet e stërmundimshme të përditshmërisë për të përballuar jetën si bujk a bari, druvar a minator, të cilit i duhej të mbijetonte në ato rrethana; dhe, nga ana tjetër, V. Blloshmi, në përsiatjet e përditshme e të vijueshme përballë portave të rënda të dijes e kulturës, që nuk reshtte së trokituri e së hapuri, për t’u endur hapësirave që i mundësonin ushqimin shpirtëror dhe nxitjen e aftësive krijuese; së dyti “shkrimtari” që mëtonte dhe ishte në përvijim e sipër të trajektores së tij estetike, ashtu heshturazi, por me ngulm; dhe, së treti, “nënshkruesi” i mesazheve në vepër, “qenia tekstore” e pranishme në krijimet e tij që synonte një komunikim me lexuesit, të cilëve u adresohesh, edhe pse në atë fazë dhe ato

¹⁰ Dominique Maingueneau, vep. cit., f. 72.

kushte në të cilat ato krijime u përfatuan, “dialogonin” brenda hapësirave të përsiatjeve të individit biografik e shkrimtar, pa mundur me të tjerë.

Shfaqen tejet domethënëse të tria këto instanca të pranishme në veprën e krijuar prej V. Blloshmit, por do të përqendrohemi në vijim në instancën e dytë, ku të dhëna të drejtpërdrejta e domethënëse na jep përkthimtarja e tij dhe pasioni për njohjen e përvojave poetike e letrare në kulturën botërore.

•Përkthimet e V. Blloshmit, si dëshmi e ushtrimit të tij ligjërimitor poetik

Në botimin “Vilson Blloshmi, Vepra I, Botimet “Almera”, 2008, studiuesi e poeti Sadik Bejko, përgatitësi i botimit, ka arritur të mbledhë dorëshkrimet e përkthimeve të bëra nga V. Blloshmi, të cilat (siç ndodhi edhe me krijimet e tij letrare origjinale), gjendeshin të shpërndara dosjeve të policisë sekrete, të mbetura aty qysh nga koha e konfiskimit të tyre dhe (shpër)përdorimit të tyre në ngritjen e akuzës së padrejtë e absurde që çoi në dënimin kapital të tij. Prej këtyre dorëshkrimeve, Blloshmi nuk arriti të botojë asnjë prej tyre, çka do t’i mundësonte komunikimin me lexuesin bashkëkohës të tij. Për fat, vlerat letrare kanë jetëgjatësi tjetër nga jeta fizike e krijuesit të tyre (por edhe e anatomuesve e xhelatëve, qofshin institucione apo individë). Ndaj ato mundën të vendosin kontaktin me lexuesin e një brezi tjetër, shumë më të vonë se bashkëkohësit e tij.

Në këtë vëllim, S. Bejko ka sjellë këto përkthime të V. Blloshmit (të botuara me këtë rend): nga Charl Bodleri (*Vera e të vetmuarit, Mallkuar, I vdekuri i gëzuar, Lugati, Epitaf për një libër të dënuar, Një kërmë, Sizina, Pendim i vonët*); nga Stefan Malarmeja (*Varri i poetit Edgar Poe*); nga Racini (*Ifigjenia, Një nga izraelitet më të reja*); nga Alfred de Museja (*Soneti i fundit*); nga Viktor Hygoi (*Ekstazë, Lizës, Kënga e Sofokliut në Selaminë, Të katër erërat e shpirtit*, nga “Legjenda e shekujve”, *Kënga e Evirdanusit*); nga Bualoi (*Pirrua dhe Sineasi*); nga Sylli Prudomi (*Sytë*); nga Gabriele d’Anunzio (*Shiu në pishnajë*). Ndërsa në vëllimin e dytë, novelën e Volterit “Zadik”, një ese nga Viktor Hygoi “Në ditën e nisjes sime” dhe një përmbledhje të dramës “Hernani”, si dhe një fragment të shkurtër nga romani “Një hero i kohës sonë” i Lermontovit.

Në studimin hyrës të kësaj vepre, S. Bejko sjell të dhëna të hollësishme dhe me shumë vlerë edhe për përkthimtarinë e V. Blloshmit, si dhe informacion për materiale të tjera në frëngjisht të grumbulluara nga V. Blloshmi, të cilat ai nuk arriti t’i përkthejë, por që formojnë gjithsesi një “antologji letrare poetike, por edhe thëniesh, sentencash a fjalësh diturake”, që dëshmojnë për ushqimin shpirtëror të Blloshmit dhe parapëlqimet letrare e estetike të tij.¹¹

¹¹ Shih më gjerë, Sadik Bejko, në *Vilson Blloshmi, Vepra I, Botimet “Almera”, 2008, f. 11-16.*

V. Blloshmi duket se ka qenë i ndërgjegjshëm për përparësinë që i jepte dhuntia e lindur e vargëzimit, ndaj kërkon ta përpunojë e zhvillojë më tej atë; për këtë arsye, nuk resht së kërkuari në përvojat nga më të larmishmet të vargëzimit, kërkon të njohë modelet e suksesshme dhe rrugët që i kanë bërë ato të tilla. Dhe lexon e lexon për të shijuar bukurinë e shkëlqimin e perlave të poezisë europiane e më gjerë, për të dialoguar me to çasteve të pambarimta të përsiatjeve të tij. Dhe ashtu vetvetishëm, atë dialogim me ato përvoja, ai guxon e nis ta shndërrojë edhe në ligjërimin poetik në shqip, në të cilin ai kishte filluar të shprehej. Ky “dialogim” me mjeshtrit e adhuruar përmes ligjërimin të tyre në gjuhën shqipe, do t’i zgjeronte mundësitë shprehëse të idiolektit të tij, do t’i kultivonte më tej konceptualizimet për lëndën që në penën e poetit shndërrohet në produkt poetik. Është një proces dobiprurës, sepse “poeti i përkthyer do të mbetet i pranishëm në atë çka përkthyesi i tij shkruan në krijimet e tij, ai do të jetë në këtë rast një këshillues, si një prej pikave të largëta të horizontit ku poeti-përkthyes kërkon të shkojë”, do të pohojmë përmes Yv Bonfuaes.¹²

Duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për vështirësitë që ka përkthimi i poezisë, edhe pse nuk ka lënë ndonjë traktat a trajtesë teorike për të, por vërehet kjo gjë nga përkujdesja që bën në përkthimet e tij.

Gjithsesi, edhe pse hedh hapat e një rishtari në fushën e përkthimit, përkthimet e Blloshmit dëshmojnë se ai priret të shqipërojë më shumë sesa të përkthejë fjalë për fjalë, të përzgjedhë e përshtasë konceptualizimet në tekstet poetike me mjetet e shqipes, herë intuitivisht e herë të tjera përmes vështirësive që hasen në ato hapa të parë; për më tepër, përballë perlash të poezisë europiane.

Nuk kemi variante tekstesh të përkthyer prej tij, që ta shohim këtë punë në proces; mund të jenë edhe variante të para që presin përpunim, por gjithsesi ato janë dëshmi të kësaj qasjeje të kujdeshme e shqipëruese të Blloshmit. Mjetet gjuhësore të përzgjedhura, plotësimi i sintagmave në shqipe për të dhënë në mënyrë sa më të përshtatshme jo thjesht domethënien e fjalës, por kuptimin e saj dhe të sintagmave në procesin përdorimor në shqip, ndjekja e një rendi të përshtatshëm e sipas ligjësive të shqipes e sintaksës poetike të shqipes, etj., janë tregues të prirjes së Blloshmit për të sjellë poetikisht konfigurimin mental, psikologjik të pranishëm në botën e poetëve në krijimet përkatëse. Vijnë të tilla, nën këtë përkujdesje, vargjet nga të tëra përkthimet e tij.

Spikat në mënyrë të veçantë përkujdesja e vazhdueshme që edhe në shqipe vargjet të ruajnë rimat, melodicitetin, tingëllimin si edhe në frëngjisht, e njëherazi fjalët të bartin domethëniet e kuptimet që bartin konceptualizimet në atë gjuhë. Përgjatë procesit të shqipërimit a transpozimit poetik, përveç

¹² Yves Bonnefoy, *Traduire la poésie?* në “Tribune internationale des langue vivante”, novembre 1989, faqe 14 (poet-përkthyes që solli me mjeshtri në frëngjisht sidomos Shekspirin, por edhe të tjerë shkrimtarë të mëdhenj).

kërkimit të fjalëve edhe në hapësirat e skajshme të fondit leksikor të shqipes, duke i bërë ato shprehëse në kontekstet përkatëse përdorimore, janë të pranishme, jo pak herë, edhe fjalë të krijuara nga vetë Blloshmi, sidomos si formime të natyrës onomatopeike, që i zgjerorin edhe tingëllimin vargut, krahas domethënieve që bartnin dhe kuptimeve që fitonin në ato kontekste; po ashtu të efektshme shfaqen edhe fjalët e reja të formuara përmes kompozimit, pranëvënies së dy temave, një procedë që ia rekomandonte edhe teksti në disa prej poezive të përkthyer.

Përkujdesja e vazhdueshme në përzgjedhjet leksikore i ka mundësuar Blloshmit që të përftojë edhe në shqipe, në tekstet e përkthyer, ngjizjen e imazheve mentale që poetët në origjinal kanë sjellë përmes gjuhës së tyre; por është po aq i kujdesshëm edhe për anën prozodike të vargjeve, sintaksën poetike, duke përmbushur rregullat kanonike të shqipes në vargëzim, duke i mundësuar në këtë mënyrë teksteve të ndjehen të bukura, të tingëllojnë po aq qartë edhe në gjuhën shqipe e, si të tilla, të ngjallin përjetime estetike të lexuesit e tyre.

Edhe nëse nuk ka njohur tipologjitë e ndryshme të të përkthyerit, Blloshmin nuk e bën të tutet aspak ajo mungesë, sepse ai i hyn punës së vështirë të përkthimit për të tjera synime: ai përkthen, në radhë të parë, për të ushqyer përsiatjet e tij intelektuale dhe të ushtrohet në ligjërimin poetik në gjuhën shqipe. Dhe në këtë rast, përkthimet e tij s'mund t'i shmangen parimit që vihet gjithnjë në dukje në përkthimin e poezisë: *përmasa estetike* përgjatë të shkruarit poetik, që është e kudondodhshme dhe përbën pikënisje për çdonjërin që e tenton ta përkthejë; sepse "përkthimi i një poezie nuk mund të jetë tjetër, veçse "i bukur", domethënë të jetë sa më në përshtatje me modelin kanonik mbizotërues të kulturës pritëse", përderisa "çdo përkthyes-poet krijon në një mënyrë a tjetër një lidhje idiolektale që do të ishte në vijimësi të tekstit prej nga niset".¹³

Dhe reflektohet kjo marrëdhënie ndërtekstore në idiolektin e tij, ku në krijimet origjinale spikatin veçanti të tilla, si prania e një rrjeti izotopik ku ngërtheheshin nocionet *qenie, ekzistencë, jetë, vdekje, shpirt, vuajtje, trishtim...*; prania e përmasave të skajshme, drejt pafundësisë, ku në çdo rast fluturimi në hapësirat e qiellores a kredhja në ato të nëntokës, janë veçse forma të shfaqjes së përmasave që qenia është pajisur për të dëshmuar ekzistencën e saj, po ashtu me përmasa të skajshme, ku dendurinë më të madhe e kanë izotopitë e *kohës e hapësirës, jetës e përjetësisë*, përmes rrjeteve leksikore të përftuara përmes leksemave *hapësirë, shpirt* (i të vdekurve apo i të gjallëve), *det* (madje edhe i qetësisë), *dallgë, varr, ditë, natë, zjarr, gjumë, ëndërr, makth, arkivol, Sahara, netët-akull, ditët-furrë, ndriçim-jetimi, hija-bonjake, botë* (faqe-bardhë apo faqe-zezë), *retë-shkrumb, toka si gogël e rrezja si lot*, etj.;

¹³ Christine Lombez, art. cit., f.358.

shprehja e ideve nëpërmjet paradoksit, antilogjisë e oksimoronit, për të mundësuar kundërvënien të brendshme në tekst, pranëvënies së dy ideve antitetike që shfaqen përmes paradoksit; pra përgjithësisht përmes figurave të kontrastit, antilogjisë, oksimoronit, antitezës apo kombinimi enjambement-kalembur ose homeotelutë, me aferezën e fjalës në vargun vijues, duke ndjekur vetëm tingujt e fundit të fjalës, por që bart kuptim tjetër, etj.

Ishte një idiolekt i përfutur edhe nga kontakti me ato përvoja që ngjizte konceptualizime të një bote që po përvijohet në krijimet e tij origjinale, por shfaqej natyrshëm edhe në sprova të tjera shkrimore të tij, në korrespondencën me kushërirën e tij, piktoresh Lume Blloshmi, apo në shënimet edhe më intime të hedhura në ditarin e tij në frëngjisht (mars-gusht 1974). Janë thënie përgjithësisht tejet të kursyera për të ngulitur çaste të përditshmërisë (por *intelligenti pauca* – thoshte latini), të tilla, si: “Tani e di se njeriu fiton, kur humbet”; “Turni i dytë në barkun e nëntokës. Nganjëherë njerëzit mbajnë mbi vete fytyra dhe emra të rremë njerëzish”; “Ka njerëz që janë si hija ime. Ata nuk më ndjekin veçse ditët me diell”; “...dhe dashuria e përjetshme zgjati vetëm tri ditë...”; “Nga erdhi ky njeri? Ai iku në një botë tjetër, doli prej këndeje”; “Më kujtohet koha e shkuar që tashmë nuk e di”; “Ti ikën, ikën dhe bie në hon/ nuk e ke çdo ditë/çdo ditë të mungon...”; “Ndarja nis aty ku fillon bashkimi, ashtu si vdekja fillon aty ku nis jeta”; etj.¹⁴

Do të jetë kjo ndjesi që e shtyn Blloshmin t’i ngjitet së përpjetës së vështirë të përkthimit të perlave të poezisë europiane. Ai po tentonte të bëhej pjesë e asaj familjeje dhe si i tillë po përpunonte edhe ligjërimin e tij që dëshironte t’u përafrohej atyre.

Më së paku, këto përpjekje përkthimore do të ishin disa sprova për ta përmirësuar e përsosur idiolektin e Blloshmit. Është një dukuri të cilën ai duhet ta ketë parë dhe njohur te vetë poetët që përkthen, shumica e të cilëve ishin po ashtu edhe ata vetë *poetë-përkthyes*. Le të kujtojmë për shembull, Bodlerin që solli në frëngjisht E. A. Poe-në, dhe njëherazi me të edhe “estetikën e efektit” në përvojat franceze e më gjerë; Leconte de Lilin, a Mallarmënë, Valerinë etj. Është një marrëdhënie ndërtekstore që ka ushqyer zhvillimin e artit poetik dhe ka mundësuar ngjitjen e tij në maja të larta të shprehjes në gjuhë të ndryshme.

Dhe këtë marrëdhënie ndërtekstore e vërejmë pa vështirësi në krijimet origjinale të Blloshmit, çka i jep atyre modernitet dhe njëherazi përkatësi në caqet e caktuara të institucionit letrar në të cilin ai mëtoi të bëhet pjesë, edhe pse atyre caqeve a vendeve s’mund t’u përcaktojmë, edhe në krijimtarinë e tij, një territor. E tillë është letërsia, e gjendur mes kufijsh, dhe jo brenda a jashtë një territori të caktuar. “Përkatësia në fushën letrare, thekson D. Maingueneau-ja, nuk është [...] mungesa e çdo vendi, por më së shumti një negociim i vështirë mes vendit dhe jo-vendit, një lokalizim i papërcaktuar që gjallon prej vetë

¹⁴ Cituar nga *Vilson Blloshmi, Vepra I*, vep. cit., f. 39-40.

pamundësisë për t'u stabilizuar, një vendndodhje paradoksale që mund ta emërtonim “paratopi”.¹⁵

Dhe duke mbajtur parasysh sërish këtë marrëdhënie ndërtekstore të Blloshmit me mjeshtrat e tij, të cilët jo thjesht i adhuroi, por edhe provoi t'i bënte të flisnin shqip, me Maingueneau-në do të pohojmë se “Larg së shprehuri mbi një terren institucional asnjans dhe të qëndrueshëm, shkrimtari e ushqen veprën e tij me një karakter mirëfilli problematik të përkatësisë së tij të mirëfilltë në fushën letrare dhe në shoqëri. Ai nuk është një lloj centauri që do ta ketë njërin pjesë të zhytur në shoqërinë e zakonit, të rëndomtë dhe pjesën tjetër, më të fismen, të kthyer drejt yjeve, por dikush procesi i të shprehurit letrar i të cilit përvijohet e ngjizet nëpërmjet vetë pamundësisë për të përcaktuar një “vend” të vërtetë.”¹⁶

V. Blloshmi guxoi të sjellë ato perla të poezisë europiane edhe në shqip, si një formë dialogimi me mjeshtrat e adhuruar, për ta pasur në shqipe modelin ligjërimor poetik, qoftë edhe vetëm për vete, për t'u bindur se teksti poetik veçse çliron energji në çdo formë që merr edhe në gjuhë të tjera e kohë të tjera.

Gjithsesi, në rastin e përkthimeve të tij, ndërsa ato mbetën thjesht *dorëshkrime*, do të ishte e tepërt ndoshta të kërkonim në to përsosmërinë, të pranishme në to, parimet ndër më të stërholluarat e teorisë së përkthimit etj. Ndaj dorëshkrimeve nuk e kemi këtë të drejtë. Por ndërsa jemi tashmë në kontakt me to përmes *veprës* së tij, kemi mundësi të gjujmë se si ato krijime kanë ardhur në një gjuhë tjetër, në një kulturë tjetër, nga këndvështrimi dhe konceptualizimi i një poeti-përkthyes si një reagim i parë ndaj krijimeve të mjeshtrëve të tij të adhuruar. Përkthimi i tekstit poetik nga poeti-përkthyes na e jep këtë të dhënë, këtë pamje. Në fund të fundit, “[...]teksti i nisjes, ashtu si teksti i mbërritjes është në një lëvizje të vazhdueshme në kohë ‘jo si një shkëmb i ngulët dhe i palëvizshëm në det’, por ‘si një platformë lundruese’, i aftë të ndryshojë kuptimin e tij me ndryshimet e gjuhës dhe të njohurive mbi botën të lexuesve”.¹⁷

Dhe Blloshmi, edhe pse në atë moshë fare të re, nuk ishte një lexues dosido, por lexuesi që provonte pareshtur format nga më domethënëset të ngjizjes gjuhësore të ndjesive, që mbetej i pakënaqur nga ajo ç' mund të arrihej; ai ishte i vetëdijshëm për negociimin e vijueshëm që duhet të bëjë edhe në lidhje me përsosjen e gjuhës ndaj asaj që zotëron tashmë, e asaj të cilën duhet të

¹⁵ Dominique Maingueneau, *Le contexte de l'oeuvre littéraire, Énonciation, écrivain, société*, Dunod, Paris, 1993, f. 28.

¹⁶ Dominique Maingueneau, po aty, f. 27.

¹⁷ Cituar nga Simone Giusti, *Trois poètes traducteurs de poètes* (përkthyer në frëngjisht nga Marie-France Merger) në RIEF Revue Italienne d'Etudes Françaises, Littérature, langue, culture, 6/2016, [En ligne [URL:/journals.openedition.org/rief/1130](https://journals.openedition.org/rief/1130); DOI:10.4000/rief1130, 19 prill 2019.

arrijë; ai ndien keqardhje që jo pak herë gjuha s'është aq e aftë sa t'i ngjizë të gjitha ato brendi që janë produkt përsiatjesh. “Sado që të shkruaj, nuk ia arrij dot komunikimit, sa keq që fjala është zhvilluar pas ndjenjës dhe shumëfish më pak se ajo”, do të theksonte ai në një nga letrat drejtuar kushërirës së tij, Lume Blloshmit.¹⁸

Mund ta vërejmë qartë këtë proces paratopik të formësimit të identitetit gjuhësor (“gjuha ime, nuk është gjuha ime”), nëse do ta zhvendosim përkatësinë ligjërimore të tij larg përsiatjeve e ligjërimit poetik, atëherë kur dhunshëm e detyrojnë të futet në të rëndomtën e shoqërisë së kohës, madje në pjesën më të infektuar ideologjikisht e politikisht, në birucat e hetuesisë, ndërsa është i detyruar t'u përshtatet në ligjërimit dhe me mënyrën e tyre të të menduarit hetuesve, me ligjërimit që gëlonte faqeve të gazetave të kohës a në seancat e vijueshme të “formave të edukimit”.

Ligjërimit në vetë të parë të Blloshmit në fragmentin e mëposhtëm, mund ta zhvendosim në vetën e dytë a të tretë, në njëjës a në shumës, dhe të mbetet i njëjtë, si një parafabrikat që arrin të shprehë e transmetojë diçka, sipas asaj që kërkohet nga të tjerët, dhe jo sipas asaj që ngjizet gjuhësisht nga individi: në një gjuhë, që duke u shprehur prej tij, njëherazi nuk është e tij. Është kaq larg kjo gjuhë në pohimin e tij në hetuesi, nga ajo e krijimeve origjinale a përkthimeve ! Ja ç'ka mbetur e regjistruar në ato proces-verbale nga ajo gjuhë e drunjëzuar: “Duke u ballafaquar me literaturën e ndaluar, reaksionare, e cila është gjetur në shtëpinë time, mendoj se këto libra grumbullohen, ruhen dhe propagandohen nga një njeri armik i pushtetit dhe i partisë. Për pasojë, unë që kam bërë një veprim të tillë, jam armik”.¹⁹

• *“Antologjia”, si dëshmuese e kahut që po merrte pozicionimi estetik i poetit*

Përkthimet a shqipërimet që V. Blloshmi ka lënë në dorëshkrim, siç theksuam më lart, janë një pjesë e një korpusi të gjerë tekstesh në frëngjisht që ai kishte arritur t'i “pronësojë”, duke i kopjuar dhe pasur të pranishme në çastet e përsiatjeve të tij të pafund e të vijueshme që përbënin, në një mënyrë a tjetër, punën e përditshme të “shkrimtarit, “uljen e tij në tavolinën e punës” dhe mëtimin për produktin letrar. Nga ky pikëvështrim, edhe këto dorëshkrime me krijime të autorëve nga më të përmendurit të shekujve XIX, XX, francezë, apo të tjerë që janë përkthyer në frëngjisht, mund të shihen, sëbashku me përkthimet, si “arkiva” nga e cila u mundësua më tej përvijimi i vlerave

¹⁸ Cituar nga *Vilson Blloshmi, Vepra I*, vep. cit., f. 188.

¹⁹ Cituar nga *Vilson Blloshmi, Vepra I*, vep. cit., në studimin hyrës të Sadik Bejkos, f. 53.

ligjërimore të Blloshmit në poezi dhe konceptualizimeve e qasjes së tij ndaj botës, për ta sjellë atë simbolikisht në krijimet e tij.

I bindur për misionin që duhet të përmbushë intelektualit, me etjen e pashuar për të zgjeruar horizontin e tij kulturor, me një përkushtim prej murgu për të përqokur në lëndën e begatë që ofronte përvoja letrare në shekuj, por me parapëlqimet më të drejtpërdrejta për prurjet poetike të shekullit XIX e XX, V. Blloshmi krijon një “antologji/arkivë” të vlerave poetike prej të cilave arrin të përkthejë vetëm një pjesë, por në tërësi t’i ketë si modele drejt të cilave priret në krijimtarinë e tij poetike.

Kanë këtë rëndësi krijimet e kopjuara me shkrim dore nga Blloshmi, sepse atje në Bërzeshtë, shumë larg prej qendrës ku ishte përqendruar fusha letrare, në atë mjedis të mbyllur e asfiksues për frymëmarrjen e poetit, ai arrinte të gjente hapësirën e duhur në të cilën mund të endeshin ëndrrat e synimet e tij poetike. Dhe në këtë hapësirë ai gjente mundësinë të bënte objekt të përsiatjeve thënie e sentenca qysh nga Euripidi, Danteja e Shekspiri, të vërente qasjet e Bualoit, Paskalit e Hegelit, por sidomos të “dialogonte” me romantikët e surrealistët, me parnasianët e simbolistët, realistët e ekzistencialistët, herë më gjatë e herë për gjërat më thelbësore; me Hygoin e Bodlerin, Malarmenë e Teofil Gotjenë, Zhan Moreasin e Pol Verlenin, Syli Prydomin e Paul Eluarin, një dialogim i etshëm që veçse e nxiste për më tej (“Po unë a do ta kem fatin të ngopem duke lexuar?”), do t’i shkruante në njërën prej letrave të tij ai kushërirës së tij, piktores Lume Blloshmi).²⁰

Është një “antologji” tejet domethënëse, ku gjenden thënie, vargje, fragmente veprash, poezi e cikle poetike nga një gamë e gjerë shkrimtarësh e përvojash letrare, të gjitha të kopjuara me shkrim dore tejet të qartë e të kujdesshëm nga ana e V. Blloshmit.²¹

Është e vlefshme kjo “arkivë”, pra, si përmasë e formimit intelektual të “vetjes biografike/personit” në përbërje të entitetit krijues, të “shkrimtarit”, me parapëlqimet e pozicionimin estetik e letrar, e të “qenies tekstore”, me marrëdhëniet a raportet ndërdiskursive e ndërtekstore me “qeniet” e pranishme në krijimet e autorëve të cilët ai kishte mbledhur, përqokur e kopjuar me kujdes.

Është një arkivë e tillë e shumëvlershme, sepse kemi të pranishme në të:

- grimca të një përvoje letrare të përbotshme, të përfaqësuar nga thënie, vargje a strofa, pohime të natyrës savante nga shkrimtarë qysh nga antikiteti greko-latin e deri në shekullin XX, qysh nga Euripidi (480-406 para erës sonë), një nga tre tragjedianët e mëdhenj të periudhës antike helene, me citime nga “Efigjenia në Aulidë”, citime në greqisht e frëngjisht; apo nga Virgjili (70-19

²⁰ Cituar nga *Vilson Blloshmi, Vepra I*, vep. cit., f. 188.

²¹ Këto materiale (të fotokopjuara) zotërohen tashmë nga familja Blloshmi, të cilën e falenderojmë që na mundësoi t’i konsultojmë.

para erës sonë), shkrimtari e poeti përfaqësues ndër më të përmendurit i letërsisë latine me citime nga “Eneida”, dhe pranë tyre edhe citime nga “Efigjenia” (Iphigénie) dhe “Fedra” (Phèdra) të Racine-it, poetit e dramaturgut klasik francez (1639-1699); nga Lukreci, poeti filozof që jetoi në shekullin e parë para erës sonë, me citime nga vepra e tij “Mbi natyrën e sendeve”; nga Juvenali (që jetoi në fund të shekullit të parë e fillim të shekullit të dytë të erës sonë), me citime prej veprës së tij “Satirat”, me fragmente në latinisht dhe të përkthyer në shqip; nga filozofi grek Demonaksi (që jetoi në vitet 70-170 të erës sonë); nga Danteja (Dante Aligeri, 1265-1321) me citime nga “Ferri” e “Purgatori”, fragmente në italisht e më tej edhe në frëngjisht (por edhe në shqip, të mbledhura ndoshta nga botimet në shqip të kohës); nga shkrimtari i madh spanjoll, Migel Servantes (Miguel de Cervantes, 1547-1616), apo nga dramaturgu i madh anglez Uiliam Shekspir (William Shakespeare, 1564-1616) etj.;

- një numër jo i vogël sentencash a fjalësh diturake në latinisht e më tej të cituara edhe në frëngjisht (apo disa të përkthyer edhe në shqip), të cilat, në ndonjë rast, kanë pranë edhe proverba nga vende të tjera (për shembull, proverba spanjolle), deri edhe citime nga Ossian-i, bard i skocez i shekullit III, autor i poemave gaelike, të përkthyer e botuara në anglisht mes viteve 1760-1763 nga Makfersoni (poeti James Macpherson, 1736-1796) e më tej të përkthyer edhe në frëngjisht e në gjuhë të tjera europiane; citime thëniesh e sentencash nga Marmonteli (Jean-François Marmontel, 1723-1799) shkrimtar, enciklopedist, historian, gramatikan e filozof francez; nga De Beranzheja (Pierr Jean de Beranger, 1780-1857), kupletist francez tejet i cituar për thëniet e tij etj.

Në varësi të tematikës së tyre, pranë vendosen edhe fjalë diturake e sentenca nga autorë shqiptarë, për shembull, shumë herë nga Sami Frashëri, por sidomos nga autorë e dijetarë francezë, por edhe nga të tjerë të cilët Blloshmi i ka gjetur në frëngjisht a shqip; nga poeti i madh anglez, Bajroni (George Gordon Byron, 1788-1824), nga kompozitori i madh gjerman Bethoveni (1770-1827), nga personalitete të hapësirës ruse/sovjetike, nga shkrimtarët në zë si Dostojevski (Fiodor Dostoïevski, 1821-1881), Gorki (Maxime Gorki, 1868-1936) apo nga kritiku i artit e letërsisë Lunaçarski (Anatoli Vassilievitch Lounatcharski, 1875-1933) etj. Krijohet me këto grimca dijesh enciklopedike një pikëvështrim për aspekte të ndryshme të përvojës njerëzore, çka dëshmon për përpjekjen e V. Blloshmit për të zgjeruar horizontin e tij në lidhje me interpretimin e asaj përvoje;

-citime pohimesh të spikatura nga filozofë qysh nga antikiteti e deri te Hegeli, për shembull, nga Aristoteli (384-322 para erës sonë) citime nga vepra e tij “Politika”; nga filozofi, matematikani, moralisti, teologu francez B. Paskal (Blaise Pascal, 1623-1662) nga vepra e tij “Mendimet” (Les Pensées); nga filozofi idealist gjerman G. Hegel (Georg Wilhelm Friedrich Hegel, 1770-

1831), nga vepra e tij “Shkenca e logjikës”, sipas shënimit të Blloshmit “Llogika III”, etj.

Spikatin, në mënyrë të veçantë, në këtë “antologji/arkivë” të tij emra të shquar poetësh që themeluan a u bënë përfaqësues rrymash, drejtimesh a kahesh letrare të shekullit XIX, XX, si Viktor Hygoi (Victor Hugo, 1802-1885), që zë një vend të rëndësishëm në romantizmin europian, prej të cilit përveç pjesëve të përkthyer, ka të pranishme edhe shumë fragmente në frëngjisht në poezi e prozë nga veprat e tij, si “Legjenda e shekujve” (La Légende des siècles), “Të mjerët” (Les Misérables), por edhe nga eseistika e studimet letrare të tij, sidomos fragmente nga vepra e Hygoit “Uliam Shekspiri” (William Shakespeare), vepër në të cilën përvijohet një përskrim e analizë e kulmeve të letërsisë botërore qysh nga antikiteti; autorë të tjerë romantikë, si Shatobriani (François-René Chateaubriand, 1768-1848) një ndër më të mëdhenjtë shkrimtarë francezë, pararendës i romantizmit, i pranishëm në këtë “antologji” me “Romanca e të mërguarit” (La romance de l’Exilé); Poe-ja (Edgar Alain Poé, 1809-1849) shkrimtari amerikan që u soll në frëngjisht nga Bodleri, me përkthimet e të cilit u risoll edhe e ashtuquajtura “estetikë e efektit”, me dy fragmente nga dy krijime të tij të marra nga “Histori të reja të jashtëzakonshme” (Nouvelles histoires extraordinaires), “Portreti oval” (Portrait ovale) dhe “Ishulli i shtojzavalles” (L’île de la fée); Lamartini (Alphonse de Lamartine, 1790-1869), poet, romancier, dramaturg, një ndër figurat e spikatura të romantizmit në Francë, prej të cilit ka përqokur e kopjuar “Prelude” dhe “Këngë dashurie” (Préludes dhe Chante d’amour), nga veprat e tij “Meditime” dhe “Meditime të reja poetike” (Méditation dhe Nouvelles méditations poétiques); Teofil Gotieja (Théophile Gautier, 1811-1872 - adhures i Nervalit (Gerard de Nerval, 1808-1855) dhe Hygoit), poet i shquar, romancier e kritik arti, romantik e i afërt me parnasianët, prej të cilit Blloshmi ka përzgjedhur një ndër krijimet më të njohura të tij, sonetin “Karvani” (La caravane), i konsideruar nga studiuesit si soneti i analogjisë mes rrugëtimit të vështirë të njeriut përgjatë historisë, që i ngjan rrugëtimit të karvanit në terrenin e shkretë të Saharasë (“karvani njerëzor në Saharanë e botës/në këtë rrugëtim që nuk ka kthim...”, shprehet Gotieja në dy vargjet e para të sonetit të tij). Këtë fat tenton ta poetizojë edhe Blloshmi në një ndër poezitë e tij më të njohura, “Saharaja”.

Por vendin më të gjerë në tekstet e përzgjedhura e zënë ato të autorëve të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, të cilët u bënë përfaqësues e udhëheqës të prirjeve moderne në poezinë e asaj kohe, të tillë si Bodleri (Charles Baudelaire, 1821-1867), një ndër përfaqësuesit më të përmendur të poetëve të kohës i prirur drejt modernitetit, i pozicionuar mes parnasianëve e simbolistëve, prej të cilit përveç tetë poezive të shqipëruara në atë ndërkohë, ka edhe një tubë krijimesh të tjera, mes të cilave “Faret” (Les phares), “Këmbana e çmendur” (La cloche fêlée), “Një kalimtareje” (A une

passante”) etj., të cilat nuk i ka titulluar, por shënon që i ka marrë nga përmbledhja “Lulet e së keqes” (Les fleurs du mal); Remboja (Arthur Rimbaud, 1854-1891) një ndër figurat më të spikatura të letërsisë franceze të gjysmës së dytë të shekullit XIX, prej të cilit ka përzgjedhur dy nga krijimet poetike më të famshme “Tingëllime/Zanore” (Voyelles) dhe “Ofelia” (Ophélie), një sprovë parnasiane e Rembosë, kushtuar mjeshtrit parnasian Théodore de Banville (1823-1891), që u përpoq të puqë në veprën e tij romantizmin me parnasizmin; Zhan Moreasi (Jean Moréas, 1856-1910), poeti simbolist grek që shkroi në frëngjisht, themeluesi i simbolizmit, prej të cilit Blloshmi shkruan nën titullin “Stances” poemën “Mos thuaj” (Ne dites pas); Verleni (Paul Verlaine, 1844-1896), *poeti i mallkuar* (siç është quajtur sipas emërtimit që ai vetë e sajoi në një prej eseve të tij), frymëzues i parnasianëve, simbolistëve e dekadentëve, prej të cilit Blloshmi ka përzgjedhur “Perëndim dielli” (Soleils couchants), të konsideruar si poezi model melankolike, të çlirimit prej demonëve që pushtojnë shpirtin, një krijim mes ëndrrës dhe makthit; Malarmeja (Étienne/Stéphane Mallarmé, 1842-1898), një prej frymëzuesve të simbolizmit, frymëzues i poezisë parnasiane e hermetike, prej të cilit Blloshmi përzgjedh “Puhë deti” (Brise marine), lirikë e konsideruar si shfaqje e shqetësimit të skajshëm poetik përballë humbjes së frymëzimit; Lekont de Lile (Charles Marie René Leconte de Lisle, 1818-1894), i konsideruar si drejtuesi i parnasianëve, prej të cilit Blloshmi përzgjedh “Zemra e Hialmarit” (Le coeur de Hialmar), krijim poetik i mbështetur në një këngë të vjetër nordike, marrë nga “Poemë barbare” (Poème barbare); Syli Prydomi (René François Sully Prudhomme, 1839-1907, laureati i parë i çmimit *Nobel* për letërsinë (1901), e anëtar i Akademisë franceze, poet, eseist, filozof po ashtu pranë parnasianëve), prej të cilit Blloshmi bën pjesë të “antologjisë” së tij poezinë “Rruga e qumështit” (La voie lactée) nga përmbledhja “Vetmitë” (Les solitudes), ku tema e vetmisë morale ngjizet përmes qasjeve romantike të poetit dhe njohurive të tij astronomike; Eluari (Paul Eluard, 1895-1952), poeti që konsiderohet ndër përfaqësuesit më të shquar të surealizmit, poet i avant-gardës, mik i kubistëve e dekadentëve, prej të cilit Blloshmi ka kopjuar një tubë prej 14 krijimesh poetike të tij, mes të cilave edhe “Për forcën e dashurisë” (Dit de la force de l’amour), një himn për dashurinë, shpresën, zhgënjimet, “Vdekja ime e gjallë” (Ma morte vivante) etj.; Apolineri (Guillaume Albert Vladimir Alexander Apollinaire de Kostroëitzky, i njohur si Guillaume Apollinaire, 1880-1918), poet, kritik dhe teoricien i artit, një prej poetëve më të mëdhenj të fillimit të shekullit XX, paraendës i surealizmit, prej të cilit Blloshmi ka kopjuar “Lamtumirë” (L’adieu), marrë nga përmbledhja “Alcools”, ndër poezitë më të njohura të tij, një poezi tejet e ndjerë për dashurinë e humbur, për të dashurën e tij Annie Playdon, me marrëdhënie të dukshme ndërtekstore me poezinë e Hygoit “Nesër, qysh në agim” (Demain dès l’aube).

Dhe, po ashtu, edhe fragmente nga Pol Klodeli (Paul Claudel, 1868-1955), poet, dramaturg, eseist, anëtar i Akademisë franceze, prej të cilit regjistron një pasazh nga vepra e tij eseistike “Arti poetik” (Art poétique) apo nga Francis Karkoja (Francis Carco, 1886-1958), shkrimtar, poet, gazetar, lindur në Kaledoninë e Re dhe vdekur në Paris, që ka shkruar në frëngjisht apo nga Pol Géraldi (Paul Lefèvre-Géraldy, 1885-1983), poet e dramaturg francez.²²

Nëpërmjet krijimeve të pranishme në këtë “antologji”, V. Blloshmi na ka lënë gjithsesi një dëshmi të rëndësishme se mbi ç’bazë po formohej statura e tij si poet; na mundëson të gjykojmë për pozicionimin e tij estetik dhe parapëlqimet letrare të “shkrimtarit” në formim e sipër; madje, nëpërmjet tyre, kemi një dëshmi që na ndihmon të vërejmë më qartë se si “shkrimtari”, në qenien e tij krijuese ndërvepron me dy instancat e tjera, me “personin biografik” e “qenien tekstore” në krijimet e tij origjinale.

Për më tepër, na ka mundësuar të krijojmë një pamje më të plotë, një dije më të gjerë enciklopedike për t’u orientuar e rikuptimësuar vetë poezitë e tij, produkt i asaj kulture me të cilën ai u ushqye e u frymëzua për t’u futur në institucionin letrar.

Përmes poezive të përzgjedhura, por edhe më gjerë, sentencave, maksimave, fragmenteve të ndryshme nga veprat letrare, të pranëvëna disa herë në bazë të tematikës së përbashkët të pranishme në to, entiteti “shkrimtar” shfaqet në një trajektore domethënëse, segmente të së cilës bartin gjurmët e përvojave letrare të klasikëve a romantikëve europianë, ashtu si edhe simbolistëve a surrealitëve, parnasionëve a “dekadentëve” që po bënin epokë në fund të shekullit XIX a fillim të shekullit XX e më tej. Në atë trajektore të përvijimit të parapëlqimeve të tij estetike do të ishin të pranishme temat e shqetësimit njerëzor e social, me një hapësirë të pamatshme të shpirtit njerëzor, vetmisë dhe ekzistencës që i pranon e i kapërcen kufijtë ngushtues të shoqërisë materiale për t’u endur në hapësirat e shpirtit, një model shumëpërmasor që do të përcaktonte edhe vetë trajektoren e rrugëtimit krijues të V. Blloshmit, konceptualizimet e tij të ngjizura më tej gjuhësisht në krijime që po nxisin në ditët tona vëmendjen e lexuesve të sotëm dhe studiuesve.

●Në mbyllje

Kontakti i lexuesit me veprën e V. Blloshmit në ditët tona (ndërsa pjesë e saj janë edhe sprovat përkthimore të tij) dhe njohja e veçantive të procesit të tij

²² Të dhënat e mësipërme për autorët dhe veprat janë mbështetur në informacionet e pranishme në botimet e veprave të autorëve në kolanat *Poésie/Gallimard*, *Collection des Classiques Garnier*, *Classique Larousse*, *Garnier-Flammarion*; në *Le Petit Robert 2 – Dictionnaire de Culture Générale*, 1991, si dhe në informacionet enciklopedike në *Wikipédia* (En ligne).

krijues, e pozicionimit estetik në trajektoren e përvojave poetike (ndërsa shqyrtimi i “antologjisë” së tij me tekste të kopjuara e “pronësuar” nga perlat e poezisë franceze të shekullit XIX, XX, na dëshmojnë për formimin dhe pozicionimin estetik të tij) mundëson të shfaqet me profil më të plotë edhe figura e *autorit* Blloshmi, të cilën vetë ai e dëshiroi, për të cilën investoi me përpjekje sizifiane, por të cilën po e arrin veçse me breza të tjerë lexuesish. Ai është tashmë i pranishëm në institucionin letrar, e njëherazi edhe shembull i asaj çka parakuptonte F. de Sossyri ndërsa pohonte se “njeriu nuk lind në natyrë por në kulturë”.²³ Dhe V. Blloshmi kësaj qenieje njerëzore synonte t’i për afrohej, ndërsa vetëdijësohej që “deti është më i vogël se një njeri”.²⁴

SUMMARY

TRANSLATIONS AND LITERARY AND CULTURAL PREFERENCES, AS AN INDICATOR OF VILSON BLOSHMI'S CREATIVE PARATOPIA

This study aims to bring data and make interpretations for a very specific case in Albanian letters, for a poet whose creative works were brought into contact with the readers only many years after the death of their author. It is about Vilson Blloshmi (shot when he was 29 years old (1948-1977)), who wrote poetry, translated literary works, mainly from French literature, but could not make public either his original poetic creations or his literary translations, because, as a result of class prejudices, he failed to become part of the literary creative field of the time.

Current contemporary approaches or points of view in literary studies, in the sciences of discourse and respectively in the analysis of literary discourse, concepts and interpretations for the biographical notions or categories themselves (the individual with the relevant extraliterary life biography), writer, speaker or recipient of utterances in the text (*enonciateur*), document/manuscript, literary text or literary work help in the examination and reinterpretation of V. Blloshmi's manuscript literary legacy, which already in contact with today's reader, has been shaped as a literary work. Translations, as well as texts in French by French authors, mainly from the 19th and 20th centuries, copied by hand from various publications in the French language, create a poetic "anthology", which, even though it did not entirely come in the

²³ Ferdinand de Saussure, *Écrit de linguistique générale*, Paris, Gallimard [Éd. Simon Bouquet et Rudolf Engler], 2002, f. 44.

²⁴ Cituar nga njëra prej letrave drejtuar kushërirës së tij, Lume Blloshmit, në *Vilson Blloshmi*, *Vepra I*, vep. cit., f. 182.

Albanian language, it nevertheless helps to know his literary and cultural preferences, his aesthetic positioning; helps the readers to get to know the poet's creative process, his creative paratopia; and, in this way, to re-understand and enjoy his original poetic creativity.